

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**ME SELI NË TIRANË**  
**“TEDA TIRANË”**

Sot, më datë \_\_ . \_\_ . 2024 (dymijë e njëzet e katër), Ortaku Themelues:

- BASHKIA TIRANË, person juridik publik, organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë me adresë të regjistruar Sheshi “Skënderbej”, Ndërtesa 2, 1001, Tiranë, Shqipëri.

Vendosi themelimin e Shoqërisë “TEDA TIRANË” Sh.p.k. me termat si më poshtë:

**KAPITULLI I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Forma Ligjore**

1. Shoqëria tregtare “TEDA TIRANË” shpk., është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara, këtu e në vijim TEDA TIRANË.
2. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.
3. TEDA TIRANË rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve të organeve të saj, llojin e shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare.

**Neni 2**  
**Parimet e përgjithshme**

1. Zbatimi me efektivitet, efikasitet, dhe ekonomicitet i funksioneve dhe detyrave;
2. Domosdoshmëria dhe proporcionaliteti në marrjen e masave për realizimin e objektivave;
3. Respektimi i parimit të konkurrencës së lirë dhe efektive, në procedura në përputhje me kuadrin ligjor mbi konkurrencën dhe ndihmën shtetërore;



4. Parandalimi dhe mënjanimi i rasteve të konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

### **Neni 3**

#### **Emri dhe Selia e Shoqërisë**

1. TEDA TIRANË është Person Juridik Publik, 100% aksionar Bashkia Tiranë.
2. Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin juridiko-civil me emërtimin e saj TEDA TIRANË
3. Selia e Shoqërisë ndodhet në mwnyrw tw pwrkohwshme nw adresën Sheshi "Skënderbej", Ndërtesa 2, 1001, Tiranë, Shqipëri.

### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja e Shoqërisë**

1. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë TEDA TIRANË, është 35 vjet, me të drejtë ripërtëritje deri në 99 vjet, në përputhje me parashikimet e akteve nënligjore të miratuara për shpalljen e zonës teknologjike dhe zhvillimit ekonomik.

## **KAPITULLI II**

### **OBJEKTI**

#### **Neni 5**

#### **Objekti i Veprimtarisë**

1. TEDA TIRANË ka për objekt veprimtarie, ndërtimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe operimin e Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA) Tiranë, në përputhje me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, duke u fokusuar në:
  - a. Asistencën kundrejt personave fizikë dhe juridik të interesuar për marrjen e zhvillimit të ndërtimit.
  - b. Fushën e industrisë së automobilave, industrinë e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT), industrinë e pajisjeve elektronike, industrinë farmaceutike, industrinë agropërpunuese, industrinë prodhuese dhe industri të tjera në përputhje me legjislacionin shqiptar.
  - c. Krijimin e një territori të veçantë me një regjim fiskal dhe doganor lehtësues për ushtrimin e aktivitetit ekonomik që nxit investimet, hapjen e vendeve të punës dhe rritjen e të ardhurave, përshpejtimin e zhvillimit rajonal dhe zgjerimin e lidhjeve ekonomike të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar, futjen e teknologjisë së përparuar dhe përshpejtimin e qarkullimit të mallrave dhe kapitaleve.
  - d. Zgjerimin e gamës së industrive operuese në treg, duke krijuar diversifikimin për të tërhequr industri prodhuese më komplekse siç janë sektori i automobilave, ICT apo elektronik, por duke qenë e hapur edhe për tërheqjen e industrive të tjera.

- e. Ofrimin e shërbimeve për të gjithë investitorët e huaj që do të operojnë në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.
  - f. Dhënien me qira të hapësirave dhe ambienteve personave fizikë e juridik që prodhojnë, tregtojnë dhe ofrojnë shërbime të ndryshme në fushën e industrive dhe teknologjive të parashikuara në këtë nen të akt themelimitstatutit dhe të sanksionuara në aktet nënligjore për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik dhe akteve të tjera të dala për këtë qëllim.
  - g. Veprimtarinë në fushën e marketingut për prodhimin e materialeve promovionale, organizimin e pjesëmarrjes në panaire ndërkombëtare, menaxhimin e ëeb faqes dhe mediave sociale të shoqërisë, duke u fokusuar më së shumti strategjinë e marketingut për tregjet e huaja.
  - h. Veprimtarinë e ndërmjetësimit apo lidhjes së kontratave ndërmjet personave fizik apo juridik, publik, shtetëror e privat vendas dhe të huaj në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj.
  - i. Hapjen e njërive menaxhuese, magazinuese, shërbim tregtimi, duke bashkëpunuar me persona fizik e juridik vendas dhe/ose të huaj.
  - j. Kryerjen e të gjitha llojeve të aktiviteteve tregtare me qëllim realizimin e veprimtarive të përshkruara më sipër.
  - k. Të kryejë investime për prodhimin, grumbullimin, përpunimin, ambalazhimin, ruajtjen dhe tregtimin e prodhimeve që do të operohen në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.
  - l. Hartimin e plane bizneseve e fizibiliteti të investimeve në ekonomi si dhe të menaxhojë projekte në teknologji, industri, tregti, etj.
  - m. Marrjen/dhënien me qira e pasurive të paluajtshme dhe kontributin drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, por gjithmonë me qëllimin e vetëm për arritjen e objektit të shoqërisë, me pjesëmarrje dhe interesa në shoqëri të tjera dhe kompani me objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të.
  - n. Pjesëmarrjen në shoqëri ekzistuese ose që do të krijohen në të ardhmen, me qëllim krijimin e subjekteve ligjore, me qëllime të njëjta apo të ngjashme.
  - o. Kryerjen në përgjithësi të të gjitha aktiviteteve industriale, tregtare, financiare, civile, të luajtshme ose të paluajtshme, që mund të lidhen direkt ose indirekt me objektin e shoqërisë e objekt të ngjashëm apo të përafërt. Shoqëria mund të kryejë aktivitete të tjera të lidhura ose plotësuese me ato të parat dhe çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm në përputhje me qëllimin e shoqërisë.
  - p. ushtrimin e çdo lloj aktiviteti tjetër të parashikuar nga ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në bazë të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të nevojshme të lëshuara nga organet kompetente të fushës.
2. TEDA TIRANË ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë siç parashikohet në këtë statut dhe në ligj.

### KAPITULLI III KAPITALI THEMELTAR DHE ORTAKËT

**Neni 6**  
**Kapitali i TEDA Tiranë**

1. Kapitali fillestar i investuar nga ortakët, përbën bazën e krijimit të fondit themeltar të mjeteve të xhiros. Administratori i dorëzon ortakëve dokumentin vërtetues për sasinë e shumave të derdhura në fazën e themelimit.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i ortakut themelues.
3. Kontributi në para do të ketë vlerën prej 100 (njëqind) lekë, i ndarë në një (1) kuotë e zotëruar nga ortaku i vetëm.

**Neni 7**  
**Ortaku i Shoqërisë dhe Kuotat e Zotëruara prej Tij**

1. Ortaku themelues i Shoqërisë tregtare **TEDA TIRANË** zotëron kuotën në shoqëri si më poshtë:  
- **Bashkia Tiranë**, në cilësinë e **Ortakut themelues** zotëron 100 % të vlerës së kapitalit themeltar të barabartë me një kuotë me vlerë të përgjithshme prej 100 (njëqind) lekë.
2. Kapitali themeltar është investuar nga Ortaku themelues në total.

**Neni 8**  
**Të drejtat dhe Detyrimet e Ortakëve**

1. TEDA TIRANË është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.
2. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.
3. Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Shoqërisë. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qira, të lihen peng në hipotekë me miratimin e Ortakëve.
4. Ortakët japin kontributin e tyre në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjëndjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria

mbron, i cili në rast se do tu përhapej personave të paautorizuar do ti shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtare të shoqërisë.

5. Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesën e tyre të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe në ligj.

6. Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk rrezikon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruara deri në atë moment.

7. Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. Ata gëzojnë, të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë.

8. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti.

## **Neni 9**

### **Abuzimi i Ortakëve ndaj Shoqërisë**

1. Ortakët e shoqërisë tregtare, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre nëse:

- a) abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- b) trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre;
- c) në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjëndjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

## **Neni 10**

### **Ndalimi i Konkurrencës**

1. Ortakët nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë. Gjithashtu, ata nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.

2. Ndalimi i përmendur më sipër mund të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga Asambleja e Përgjithshme me 51% të votave.

3. Ky autorizim mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendur në të, por jo për një periudhë më të gjatë se një vit pas humbjes së kësaj cilësie.

4. Nëse ndonjëri prej ortakëve shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:

- a) ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
- b) të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
- c) të ngrëjë padi për shpërblimin e dëmit.

5. Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund t'i kërkojë secilit prej ortakëve:

- a) T'ë pranojë që transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;

b) T'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;

c) T'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.

## Neni 11

### Largimi i Ortakut nga Shoqëria dhe Likuidimi i Kuotës

1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

2. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

3. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njuh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

4. Ortaku që kërkon largimin nga Shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë Shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

5. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj Shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

## Neni 12

### Përrjashtimi i Ortakut

1. Asambleja e Përgjithshme në bazë të një vendimi të zakonshëm, mund t'i kërkojë gjykatës përrjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, apo nuk ka paguar kontributin si pasojë e një financimi, investimi, shtimi në kapital dhe detyrime të tjera të parashikuara në Statut apo nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për përrjashtimin e tij sipas parashikimeve të Statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përrjashtim.

2. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përrjashtimin e ortakut, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:

a) Me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkaktonte dëme Shoqërisë ose Ortakëve të tjerë;

b) Me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel Statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;

c) Përrfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis Shoqërisë tregtare dhe Ortakut;

d) Me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të Shoqërisë.

3. Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së Shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.
4. Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.
5. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë Shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.
6. Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por nëse Shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

### **Neni 13**

#### **Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit**

1. Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asamblea e Përgjithshme në përputhje me legjislacionin tregtar shqiptar.
2. Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të ortakëve.
3. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të kontributeve në para, me anë të kontributeve në natyrë ose me përfshirjen e rezervave dhe fitimit.
4. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet nëpërmjet emetimit të kuotave të reja, apo nëpërmjet rritjes së vlerës së tyre. Kuotat duhet të jenë të nënshkruara dhe vlera e tyre do të jetë e shlyer plotësisht.
5. Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

### **Neni 14**

#### **Pronësia mbi Kuotat dhe Transferimi i tyre**

1. Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) dhurimit;
  - d) në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.
2. Kuotat mund t'u transferohen personave të tretë vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve/Ortakut të Vetëm. Në çdo rast, ortakët e shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes. Çdo transferim duhet të bëhet në përputhje me dispozita ligjore në fuqi dhe duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### **Neni 15**

#### **Anullimi i Kuotave**

1. Kuotat mund të anulohen në çdo rast me miratimin e ortakut përkatës dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i rrjedhin ortakut nga zotërimi i kuotës, shuhet me anullimin e tyre.

2.Ndërsa likuidimi i saj do të bëhet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9901/2018 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

## KAPITULLI IV ORGANET E SHOQËRISË

### Neni 16

#### Asambleja e Përgjithshme

1. Organi më i lartë vendimmarrës i TEDA TIRANË është Asambleja e Përgjithshme.
2. Përfaqësuesi i Asamblesë së Përgjithshme është kryetari i Bashkisë.
3. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të cilat kërkojnë  $\frac{3}{4}$  (tri të katërtat) e votave në rastet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
4. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
5. Nëse TEDA TIRANË, zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
6. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
  - a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) investime;
  - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
7. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.
8. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## Neni 17

### Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme është e detyruar dhe me çdo kusht të mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë në rastet e mëposhtme:
  - a) Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim;
  - b) Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara;
  - c) Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% (pesë përqind) të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara;
  - d) Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë.
  - e) Në rastet e parashikuara në pikën një dhe tre më sipër, përpara Asamblesë së Përgjithshme paraqitet një raport i përgatitur nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur;
  - f) Në rastet e parashikuara në pikën një dhe tre Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

## Neni 18

### Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.
2. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

## Neni 19

### Kourumi i Nevojshëm dhe Vendimmarrja

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë votë, që zotërojnë më shumë se 30% (përqind) të kuotave.
2. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që

zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

3. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbliidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, Asambleja mbliidhet përsëri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.

4. Asambleja e Përgjithshme, vendos me tri të katërat (3/4) e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

5. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, kanë mundësinë e pjesëmarrës në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

6. Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave.

## **Neni 20**

### **Procesverbali i Mbledhjes së Asamblesë**

1. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme.

2. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

3. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë se Përgjithshme.

4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

## **Neni 21**

### **Hetimet e Posaçme**

1. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

2. Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë me të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë Asamblesë së Përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit në të kundërt brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim brënda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.

3. E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, duhet të ushtrohet brënda 3 (tre) viteve nga data e regjistrimit të Shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të

themelimit, si dhe brenda 3 viteve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

4. Në rastet e vendimeve të parregullta të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë ti kërkojë gjykatës kompetente shfuqizimin e këtyre vendimeve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit apo statutit.

5. Procedurat përpara gjykatës ndiqen nga një përfaqësues i posaçëm i Shoqërisë i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Kreditorët apo ortakët e sipërpërmendur kanë të drejtë të kërkojnë përpara gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit kur ka dyshime në lidhje me të, për përfaqësimin e tij jo në interes të shoqërisë.

6. Rastet e hetimeve të posaçme dhe shfuqizimit të vendimeve të parregullta do të rregullohen sipas neneve 91 dhe 92 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar.

## **Neni 22**

### **Administratori**

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Statuti mund të caktojë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.

2. Administratori i shoqërisë TEDA TIRANË do të emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar.

3. Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i Shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

## **Neni 23**

### **Të Drejtat dhe Detyrimet e Administratorit**

1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;

d) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;

e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

f) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

g) raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut.

2. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e Administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me Shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Administratori, mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblesë të përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.
4. Nëse Asambleja e Përgjithshme, nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
5. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas ligjit 9901/2018, të ndryshuar.

#### **Neni 24**

#### **Shpërblimi i Administratorëve**

1. Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Shpërblimi, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.
3. Nëse Shoqëria është në vështirësi financiare, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.
4. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të Shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

### **KAPITULLI V**

### **ADMINISTRIMI FINANCIAR I SHOQËRISË**

#### **Neni 25**

#### **Audituesi Ligjor**

1. Në rast se kërkohet nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël mund ti besohet një ose disa audituesve ligjor.
2. Audituesi Ligjor mund të shkarkohet në çdo kohë sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

**Neni 26**  
**Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor**

1. Veprimtaria ekonomiko-financiare e shoqërisë nis me regjistrimin e saj në organet tatimore, ndërsa për vitet në vijim nga data 1 janar deri me 31 dhjetor të çdo viti .
2. Shoqëria do të mbajë kontabilitetin në monedhën shqiptare (Lekë).
3. Në fund të çdo periudhe të ushtrimit të aktivitetit hartohet pasqyrat financiare, brenda afateve dhe konform ligjeve në fuqi.
4. Dokumentat e kontabilitetit, të shoqëruara nëse është e nevojshme nga relacioni i ekspertit kontabel të autorizuar, duhet t'u komunikohen ortakeve dhe të vihen në dispozicionin e tyre pranë selise së shoqërisë, te pakten 15 ditë përpara datës së Mbledhjes së Asamblesë.

**Neni 27**  
**Shpërndarja e Fitimeve**

1. Koha, mënyra dhe shuma e fitimit që shpërndahet vendoset rast pas rasti nga Asambleja e Ortakëve të shoqërisë TEDA TIRANË.
2. Shoqëria do të krijojë fondin rezervë nga fitimet e saj vjetore sipas dispozitave ligjore të detyrueshme të ligjit Shqiptar për rezervën ligjore të detyrueshme.

**Neni 28**  
**Kufizimet e shpërndarjes, çertifikata e aftësisë paguese, përgjegjësitë personale për shpërndarjet e ndaluara**

1. Shoqëria mund t'u shpërndajë dividendin për Ortakun e Vetëm , vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
  - a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
  - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
2. Administratori lëshon një çertifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendit përmbush kërkesat e mësipërme.
3. Kur gjendja e Shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendit nuk i përmbush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojnë këtë çertifikatë.
4. Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e çertifikatës së aftësisë paguese.
5. Administratori, i cili nga pakujdesia lëshon një çertifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjet personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendit të shpërndarë.
6. Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar çertifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të çertifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, sipas përcaktimeve të cituara më lartë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

## **KAPITULLI VI MARRËDHËNIET E PUNËS**

### **Neni 31**

1. Marrdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.
2. Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontratës individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve.
3. Marrdhëniet midis Shoqërisë e Sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

### **Neni 32**

1. Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj në rrugë civile.

### **Neni 33**

#### **Modifikimi i Formës Ligjore**

1. Forma ligjore e Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.
2. Shoqëria e re do të përmbushë të gjitha procedurat ligjore të regjistrimit në Shqipëri.

### **Neni 34**

#### **Prishja e Shoqërisë**

1. Kjo Shoqëri do të priset në rastet kur:
  - a) Kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
  - b) Me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
  - c) Në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
  - ç) Në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit nr. 9901/2018, i ndryshuar;
  - d) Në raste të tjera, të parashikuara në këtë statut;
  - dh) Në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
  - e) Për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.
2. Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga Administratorët.

### **Neni 35**

#### **Likuidimi i Shoqërisë**

1. Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

2. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.
3. Çdo person i interesuar, ka të drejtë t' i kërkojë gjykatës zëvendesimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cënohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.
4. Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare priset me vendim gjykate. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.
5. Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet ex officio, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
6. Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i Shoqërisë ndiqet nga shënimi "në likuidim". Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj brenda 30 ditëve. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

### **Neni 36**

#### **Të Drejtat dhe Detyrimet e Likuiduesit**

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të Shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të Shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas Nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

### **Neni 37**

#### **Bilancet**

1. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së Shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave.
2. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

### **Neni 38**

#### **Shpërndarja e Aktiveve**

1. Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference.
2. Pasuritë, që i janë dhënë Shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo tituli u kthehen ortakëve apo aksionarëve. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e Shoqërisë.

### **Neni 39**

#### **Likuidimi i Thjeshtëzuar**

1. Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet një procedure të përshpejtuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit.
2. Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar, njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e Shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar.
3. Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përveç administratorëve, ortakët apo aksionarët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare deri në shumat e marra.

## **KAPITULLI VII DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 40**

1. Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### **Neni 41**

1. Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet/rregullohet sipas legjislacionit tregtar dhe akte të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 42**

1. Ky Statut pëpilohehet në 4 (katër) kopje të njëjta në gjuhën shqipe e nënshkruhet pa vërejtje nga Ortaku Themelues

## **ORTAKU THEMELUES:**

**BASHKIA TIRANË**

Përfaqësuar nga:

**KRYETARI**

**Erion VELLAJ**

